

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE	
MINISTARSTVO EKONOMIJE	
MINISTRY OF ECONOMY	
Njesia Org. Org. Jedin Org. Unit	01/3
Nr. i faqesve Broj stranica No. pages	2428
Nr. Prof. Br. Prof. Prof.No:	13-06-25
Data: Datum: Date:	PRISHTINE/A
NO.1	

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVES -
FUSHË KOSOVË

KMDK.SH.A	
KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NE KOSOVE SH.A	
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C	
KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DD	
Nr.	02-88/03
Dt.	26/05/2025
Fushë Kosovë	

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR PËR VITIN QË
PËRFUNDON MË 31 DHJETOR 2024

Prishtinë, Maj 2025

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3 - 5
PASQYRAT FINANCIARE PËR PËRIUDHEN KONTABEL 31 DHEJETOR 2024.....	1 - 18

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin e KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVES - PRISHTINË

Opinion i kualifikuar:

Ne i kemi audituar Pasqyrat Financiare përcjellëse **KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVES** tutje Referuar ("KMDK") me adresë: Sheshi i Lirisë, pn, Fushë Kosovë, Republika e Kosovës, që nga Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2024, Pasqyrën e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që ka përfunduar, Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet, si dhe Përmbledhjen e Politikave Kryesore të Kontabilitetit dhe Shënimeve Shpjeguese.

- Për mendimin tonë përveç çështjeve të theksuara të Baza për opinion të kualifikuar, Pasqyrat Financiare të "KMDK", paraqesin gjendjen e drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar më 31 dhjetor 2024, si dhe performancën financiare dhe rrjedhat e saj të parasë për vitin e përfunduar, në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion të kualifikuar:

- Sipas shënimit 6 të pasqyrave financiare, vlera e raportuar e pasurisë, pajisjeve dhe impianteve ishte: 1,624,108 Euro më 31 dhjetor 2024 (2023: 1,820,850 Euro). Sipas kërkesave të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 16 - Pasuritë, pajisjet dhe impiantet, entitetet që aplikojnë modelin e rivlerësimit janë të detyruara të kryejnë rivlerësimin në mënyrë të rregullt, për të siguruar që vlera kontabël e aseteve të mos dallojë ndjeshëm nga vlera e tyre e drejtë në datën e raportimit. "KMDK" nuk ka realizuar rivlerësimin e këtyre aseteve për një periudhë teje të gjatë, andaj mungesa e rivlerësimit të rregullt rrezulton që vlerat kontabël të mos pasqyrojnë saktë gjendjen ekonomike të aseteve, gjë që mund të ndikojë në besueshmërinë dhe përfaqësimin e drejtë të pasqyrave financiare.
- Siç është prezantuar në shënimin 7 - Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera, shuma e raportuar ishte 1,797,285 Euro më 31 dhjetor 2024 (krahasuar me 1,482,395 Euro më 31 dhjetor 2023). Gjatë auditimit është vërejtur se "KMDK" nuk ka bërë vlerësim dhe njohje të provizionit për humbje të mundshme nga arkëtimi i këtyre llogarive. Sipas procedurave të brendshme, praktikave të mira kontabël dhe standardeve përkatëse të raportimit financiar, entitetet janë të obliguara të bëjnë vlerësim të rrezikut për mospagesë, dhe në rastet kur ekziston mundësi që një pjesë e llogarive të mos arkëtohet, duhet të njohet provizion për humbje të pritshme (lejimet për borgjet). Për më shume, në kuadër të verifikimit të llogarive të arkëtueshme, u aplikua procedura e konfirmimit të drejtpërdrejtë përmes dërgimit të letrave konfirmuese të një përzgjedhje klientësh, bazuar në analizën e riskut. Nga përgjigjet e marra, në një rast u evidentua mospërputhje midis shumës së raportuar nga subjekti dhe shumës së konfirmuar nga klienti përkatës.



ProAudit

Tel: +383 44 126 395

Email: proaudit34@gmail.com

Përdorimi i metodave alternative të auditimit nuk na ka mundësuar të bindemi për saktësinë dhe plotësinë e raportimit të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2024, si dhe nuk kemi marrë garanci të mjaftueshme për vlefshmërinë dhe arkëtueshmërinë e plotë të këtyre llogarive.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësia jonë është të japim një mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimit e bërë. Gjatë angazhimit tonë, ne ishim të pavarur nga shoqëria dhe në përputhje me kodin e etikës për profesionistët kontabël (kodi i BSNEPK), së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë. Po ashtu ne kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit - Theksim i Çështjes

Auditimi përfshinë ekzaminimin në bazë të testeve të dhënave në mbështetje të shifrave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori konsideron të përshtatshëm kontrollin e brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të kompanisë në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të duhura në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së një mendimi në efektivitetin e kontrollit të brendshëm të kompanisë. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmërinë e politikave të përdorura si dhe nevojën e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu edhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. Ne terheqim vemendjen lidhur me momentet e mëposhtme:

Përgjegjësitë e menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre Pasqyrave Financiare në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF). Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant; për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare; të jenë të liruar nga gabimet materiale, nga mashtrimi apo nga gabimi; zgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit; bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim mbi këto Pasqyra Financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe të planifikojmë e zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë Pasqyrat Financiare të liruar nga gabimet materiale. Auditimi përfshinë zbatimin e procedurave që të arrijmë dëshmi audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në Pasqyrat Financiare.




ProAudit

Tel: +383 44 126 395

Email: proaudit34@gmail.com

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të Pasqyrave Financiare, qoftë nga gabimi apo nga mashtrimi. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e brendshëm relevant për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare të entitetit, në mënyrë që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Gjithashtu, auditimi përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimi i prezantimit të përgjithshëm të Pasqyrave Financiare. Ne besojmë që dëshmitë për auditim që i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura që të ofrojmë bazë për mendimin tonë të auditorit.

Hajdar Hoxhaj



Auditor Ligjor Nr. 88



ProAudit



Adresa: Rr. Behar Begolli,
Linda Premium, 10 000 Prishtinë

Prishtinë, më
14 maj 2025



Pasqyrat financiare vjetore

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
(NUI# 811380617)

Për periudhën kontabël të përfunduar më 31.12.2024

Përmbajtja:

	<u>Faqe</u>
Deklarata e pajtueshmërisë	1
Pasqyra e pozicionit financiar më 31.12.2024	2
Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31.12.2024	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31.12.2024	4
Pasqyra e rrejdhes së parasë për vitin e mbyllur më 31.12.2024	5
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për fundin e vitit kontabël 2024	6 – 18


Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
(NUI# 811380617)

Deklaratë e Pajtueshmërisë

-Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2024

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues kontabël 2024 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, rrjedhjes së parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim* dhe UA-të në fuqi.

Drejtori i përgjithshëm


Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula

Drejtori Financiar


Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Prishtinë,

01.04.2025

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2024

	Shënimi	31.12.2024 Euro	31.12.2023 Euro
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	5	1,767,743	536,813
Stoqet	6	111,419	37,993
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	7	1,797,285	1,482,395
Parapagimet dhe kërkesat e tjera	8	9,153	138,922
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		3,685,600	2,196,123
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	9	1,624,108	1,820,850
Pasuritë tjera afatgjata		-	-
Gjithsej pasuritë afatgjata		1,624,108	1,820,850
Gjithsej pasuritë		5,309,708	4,016,973
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare	10	220,489	179,370
Te hyrat e shtyra nga grantet, pjesa afatshkurtër	11	34,757	34,758
Të pagueshmet tjera	12	73,618	104,521
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		328,864	318,649
Detyrimet afatgjata			
Te hyrat e shtyra nga grantet, pjesa afatgjatë	11	339,829	174,586
Gjithsej detyrimet afatgjata		339,829	174,586
Gjithsej detyrimet		668,693	493,235
EKUITETI			
Kapitali aksionar		25,000	25,000
Fitimet e mbajtura		4,616,015	3,498,738
Gjithsej ekuiteti		4,641,015	3,523,738
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		5,309,708	4,016,973

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti më 1 prill 2025.

Drejtori i përgjithshëm

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula

Drejtori financiar

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Kontabilisti i Certifikuar

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Nr. Certifikatës

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënimi	2024 Euro	2023 Euro
Të hyrat	12	3,385,907	2,881,076
Kostoja e shitjes	13	1,082,106	415,919
Fitimi / (humbja) bruto		2,303,801	2,465,157
Të ardhurat tjera		42,819	40,026
Shpenzimet e pagave	14	327,205	934,423
Shpenzimet administrative	15	120,184	111,556
Shpenzimet e zhvlerësimit	9	599,164	721,372
Shpenzimet tjera		3,500	7,205
Fitimi / (humbja) operativ		1,296,566	730,627
Të hyrat nga interesi		-	-
Shpenzimet e interesit		-	-
Fitimi / (humbja) para tatimit		1,296,566	730,627
Shpenzimet e tatimit në fitim	16	131,357	87,798
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,165,209	642,829

* Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare individuale.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Pasqyra e e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Kapitali aksionar Euro	Fitimet e mbajtura Euro	Rezervat e tjera Euro	Gjithsej Euro
Gjendja më 1 janar 2023	25,000	1,585,411	1,274,898	2,885,309
Fitimi / (humbja) i/e vitit 2023	-	642,829	-	642,829
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Rezerva e rivlerësimit	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	(4,400)	(4,400)
			-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	25,000	2,228,240	1,270,498	3,523,738
Fitimi / (humbja) i/e vitit 2024	-	1,165,209	-	1,165,209
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Rezerva e rivlerësimit	-	-	-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-	(4,400)	(4,400)
Korrigjimet e periudhave paraprake	-	(43,532)	-	(43,532)
			-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	25,000	3,349,917	1,266,098	4,641,015

* Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare individuale.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Pasqyra e rrjedhjes së parashë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënimi	2024 Euro	2023 Euro
Rrjedha e parashë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		1,165,209	642,829
Rregullimet për:			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		599,164	721,372
Humbja (Fitimi) kapital			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		(314,889)	(240,944)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		(73,426)	(4,012)
(Rritja) / zvogëlimi në parapagime dhe kërkesat e tjera		129,769	(34,469)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera		41,119	(452,566)
Rritja / (zvogëlimi) në të hyrat e shtyra tatimore		165,242	(32,122)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		(30,903)	69,761
Rrjedha neto e parashë nga aktivitetet operative		1,681,284	669,849
Rrjedha e parashë nga aktivitetet investuese			
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		(402,422)	(139,419)
Pagesat për investimet në pjesëmarrje		-	-
Dividendat e arkëtuara		-	-
Rrjedha neto e parashë nga aktivitetet investuese		(402,422)	(139,419)
Rrjedha e parashë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë		-	-
Rezerva e rivlerësimit		(4,400)	(4,400)
Korrigjimet e periudhave paraprake		(43,532)	-
Terheqjet/Dividenda e paguar		-	-
Arkëtimet (Pagesat) nga (për) kreditë dhe huatë		-	-
Arkëtimet (Pagesat) nga (për) lizing financiar		-	-
Rrjedha neto e parashë nga aktivitetet financuese		(47,932)	(4,400)
Rritja/(zvogëlimi) neto i parashë dhe ekuivalentëve të parashë		1,230,930	526,030
Paraja dhe ekuivalentët e parashë në fillim të vitit		536,813	10,783
Paraja dhe ekuivalentët e parashë në fund të vitit	5	1,767,743	536,813

* Shënimet shpjeguese shoqëruese janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare individuale.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

1. Informacion i përgjithshëm

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A. (që më poshtë do t'i referohemi si "Kompania") është themeluar si Shoqëri Aksionare, në 21/12/2005, dhe është e regjistruar në Agjencionin për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës.

Selia e regjistruar e Kompanisë dhe vendi kryesor i aktivitetit është në Fushë Kosovë, Sheshi i Lirisë, pn.

Aktiviteti kryesor i biznesit është Aktivitetet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarate e përputhshmërisë së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM (SNRF për NVM) të cilat janë kornizë raportuese e kërkuar me Ligj në Kosovë.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Euro, e cila është monedha funksionale për Kompaninë.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacion mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në paragrafin e mëposhtëm ashtu si edhe në shënimet shpjeguese të mëposhtme.

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

3. Përmbledhje e politikave kontabël

(a) Ndryshime në politikat kontabël

Nuk ka ndryshime në politikat kontable në vitet e paraqitura.

(b) Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave, përveç diferencave që rrjedhin nga konvertimi i instrumenteve të kapitalit të vlefshme për shitje (nëse ka).

(c) Instrumentet financiare

Instrumentet financiarë jo-derivativë të Kompanisë, përfshijnë llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to dhe llogari të pagueshme. Gjatë periudhave të raportimit nuk ka investime në letra me vlerë të kapitalit apo instrumente borxhi në vazhdimësi të aktivitetit.

Instrumentet financiarë jo-derivative janë matur fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumenta jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me përvetësimin e tyre. Njohja në vijim e instrumenteve financiarë jo-derivativë përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet në rast se Kompania bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë nuk njihen nëse të drejtat kontraktuale të Kompanisë ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Kompania i transferon aktivin financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë regjistruar në datën e tregtimit, p.sh. datën në të cilën Kompania zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Detyrimet financiare nuk njihen nëse detyrimet e Kompanisë të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Mjete monetare dhe ekuivalente me to

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në banka, dhe depozita bankare afatshkurtra. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parave, arka dhe banka përfshijnë edhe depozitat e mbajtura si garanci nga banka me maturitet me pak se tre muaj nga data origjinale.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

3. Përmbledhje e politikave kontabël

Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar pakësuar për humbjet për zhvlerësime.

Furnitorë dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar.

Hua dhe kredi

Në vijim të njohjes fillestare, huatë dhe kreditë paraqiten me kosto të amortizuar me ndonjë diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së riblerjes që njihet në fitim ose humbje gjatë periudhës së huamarrjes në bazat e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta financiarë të tjerë jo-derivativë maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi për të ardhurat dhe shpenzimet financiare është diskutuar në notën 3(k).

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë njihet me vlerën nominale.

(d) Aktivët afatgjatë materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjatë materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi (nëse ka)

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme për përdorim, si dhe kostot e montimit, heqjes së elementëve dhe kthimi i mjedisit ku kanë qënë të vendosur, në gjëndjen e mëparshme. Shpenzimet kapitale për aktivet gjatë ndërtimit kalojnë në llogarinë "Punë në proces" dhe kapitalizohet duke u transferuar në kategorinë e aktivit përkatës kur ai ka mbaruar, e në këtë kohë fillon dhe aplikohet amortizimi me normën përkatëse të kategorisë.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjatë materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjatë materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjatë materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

3. Përmbledhje e politikave kontabël

(d) Aktivet afatgjata materiale

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet me metodën lineare me norma të cilat përafrojnë me jetën mesatare ekonomike të dobishme të aktivit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen. Jetët e dobishme të pritshme për periudhën korrente dhe atë krahasuese janë si vijon:

	<u>2024</u>	<u>2023</u>
• Mjete transportuese	20%	20%
• Pajime dhe makineri	10%	10%

(e) Aktivet marrë me qera

Aktivitet me qira janë me qira operacionale dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

(f) Inventarët

Inventarët mbahen me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara për përfundimin dhe shitjen e tij. Kostot përfshijnë shpenzimet që ndodhin në blerjen e inventarëve dhe shpenzimet për ti sjellë ato në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese.

(g) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive zhvlerësimi që tregon se një ose më tepër ngjarje që kanë ndodhur kanë patur një ndikim negativ në flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare të aktivit financiar.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivitet financiare të cilat janë të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare, vlerësohet bashkarisht në grupe që mbarti karakteristika të ngjashme risku.

Te gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje.

Një humbje zhvlerësimi mund të anulohet nëse ulja në zhvlerësim ka ndodhur për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi. Për aktivet financiare që maten me kosto të amortizuar, anulimi njihet në fitime ose humbje.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(li) Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi, apo njesia gjeneruese e parave tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitime ose humbje.

(h) Përfitimet e punonjësve

Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet e detyrueshme në përputhje me legjislacionin lokal. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

Lejet vjetore të paguara

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhet në këmbim për shërbimin e punonjësve gjatë periudhës.

(i) Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të shkuar dhe që ka mundësi të kërkohej një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin dhe që mund ti bëhet një vlerësim i besueshëm i detyrimit. Nëse efekti është material, provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të parasë para taksavë me një normë që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe, aty ku është e përshtatshme edhe rrezikun specifik të detyrimit. Provizionet rishikon në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më i mundshëm kushti për të cilin do të kërkohej materializimi i burimeve ekonomike për të shlyer detyrimin, atëherë provizionet kthen pas. Provizionet përdoren vetëm për arsyen për të cilën janë njohur fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje operationale të ardhshme. Aktivët apo detyrimet e rastit nuk njihen.

(j) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihet në fitim ose humbje kur rreziqet dhe përfitimet thelbësore i janë transferuar blerësit.

Të ardhurat nga shërbime të kryera njihen në fitim ose humbje në përpjesëtim me fazën e përmbushjes së transaksionit në datën e raportimit. Faza e përmbushjes vlerësohet duke iu referuar vrojtimit të punës së kryer.

Asnjë e ardhur nuk njihet në qoftë se ka pasiguri të mëdha për sa i përket rikuperimit të pagesës së detyrueshme, kostove shoqërore ose kthime të mundshme të mallrave apo përfshirje të vazhdueshme të drejtimit me mallrat.

(k) Shpenzimet

Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operationale njihet në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Stimujt e marrë për qiranë njihen si pjesë integrale e pagesës totale të qirasë përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

3. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozita bankare nese ka, dhe fitimet nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen dhe përlogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë, paluhatshmeria e zbritjeve mbi provizionin, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshime ne vleren e drejte te aktiveve financiare per fitim ose humbje, dhe humbje zhvlerësimi te njohura mbi aktivet financiare. Të gjitha kostot e huave njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(l) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin ose humbjen e vitit përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital apo ne te tjera te ardhura permbledhese.

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur ne perputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur me normat tatimore qe pritët te aplikohen per diferencat e përkohshme kur ato te anulohen, duke përdorur shkallë tatimore që janë në fuqi ose që hyjnë në fuqi menjëherë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren diferencat e përkohshme. Aktiv i tatimor i shtyrë rishikohet ne cdo date raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është me e mundur të realizohet përfitim fiskal.

(m) Standarde dhe politika/interpretimet të reja ende të pa-adoptuara

Një grup standardesh te reja, ndryshime ne standarde dhe interpretime të standardeve nuk janë ende efektive per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2024, si dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare te shoqerise. Asnjë nga këto nuk pritët të ketë efekt në pasyrat financiare të Shoqërisë.

(m) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Disa nga politikat kontabël të Shoqërisë dhe notave shpjeguese kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo-financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime matjeje dhe/ose prezantimi bazuar në metodat në vijim. Ku është e aplikueshme informacion i mëtejshëm rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë është prezantuar në notat shpjeguese specifike të aktiveve dhe detyrimeve.

Kërkesa për arkëtim

Vlera e drejtë e kërkesave për arkëtim, klientëve dhe llogarive të tjera të arkëtueshme, është matur si vlera aktuale e flukseve të ardhshme, skontuar me normën e interesit të tregut në datën e raportimit.

(n) Informacion krahasues

Informacioni krahasues është paraqitur vazhdimisht në aplikimin e politikave kontabile të Shoqërisë. Aty ku është e nevojshme, shuma të caktuara në pasqyrat financiare të vitit paraardhës janë riklasifikuar në përputhje me raportimin e vitit aktual.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

4. Drejtimi i riskut financiar

Shoqëria është ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtëm nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërm, objektivat, politikat dhe proceset e Shoqërisë për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit. Shënime të mëtejshme sasiore janë të përfshira në këto pasqyra financiare.

Drejtimi i Shoqërisë mbart përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e politikave të Shoqërisë për menaxhimin e riskut.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përball Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe në aktivitetet e Shoqërisë.

Shoqëria, përmes trajnimeve dhe menaxhimit të standardeve dhe procedurave, synon të zhvillojë një ambient kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar në të cilin gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Grupi në zyrat qendrore vërtet sesa menaxhimi monitoron përputhjen me politikat e procedurat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë dhe të grupit dhe rishikon përshtatshmerinë e strukturës së menaxhimit të riskut në lidhje me rreziqet që përball Shoqëria.

Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, overdraftet bankare, kërkesat për arkëtim, llogaritë e pagueshme, të shtyrat dhe detyrime të tjera afatshkurtra.

Risku i kredisë

Në saj të volumit të madh dhe të llojshmërisë së klientëve bazë të Shoqërisë, përqendrimi i riskut për sa i përket kërkesave për arkëtim është i limituar. Provizioni për kërkesat e dyshimta për arkëtim është caktuar në shumën e konsideruar të nevojshme për të mbuluar risqet potenciale në mbledhjen e balancave të kërkesave për arkëtim.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria do ndeshet në vështirësi në përmbushjen e angazhimeve të lidhura me detyrimet financiare që do shlyhen duke dhënë para te gatshme ose ndonjë aktiv financiar tjetër.

Risku i tregut

Risku i normave të interesit

Shoqëria përballët me riskun e normës së interesit të rrjedhës së parave në lidhje me overdraftin i cili është me një normë të ndryshueshme. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje të derivateve për t'u mbrojtur nga ky risk.

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria ka balanca të konsiderueshme në Euro nga klientët e saj dhe kundrejt furnitorëve të saj, fakt i cili e ekspozon kompaninë ndaj riskut të kursit të këmbimit. Drejtimi nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje të derivateve për t'u mbrojtur nga ky rrezik

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

4. Drejtimi i riskut financiar (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë

Me anën e menaxhimit të riskut të normave të interesit dhe të pozicionit valutor, Shoqëria synon të reduktojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Në një periudhë afatgjatë, sidoqoftë, ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Shoqëria nuk ka pase në këte vite kredi dhe transaksione me valuta tjera.

Menaxhimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë e investitorëve dhe kreditorëve dhe të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të biznesit. Zyra Qendrore monitoron kthimet nga kapitali, të cilat Shoqëria i përcakton si të ardhura neto të shfrytëzimit ndaj totalit të kapitalit aksionar. Drejtimi dhe zyra qendrore monitorojnë gjithashtu nivelin e dividendëve ndaj aksionareve të zakonshëm.

Shoqëria kërkon që të mbajë një balancë midis kthimeve më të larta të cilat janë të mundshme nga nivele të larta borxhi dhe me avantazhet dhe sigurinë që të jep pozicioni me kapital të fuqishëm.

Nuk ka ndryshime në mënyrën e menaxhimit të kapitalit gjatë këtij viti. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të kapitalit të vendosura nga ente të jashtme rregullatorë.

Ndikimi mbi likuiditetin

Volumi i financimit është reduktuar shumë kohët e fundit. Këto rrethana mund të ndikojnë në aftësinë e shoqërisë për të marrë kredi të reja nëse nevojiten, dhe të rifinancojnë huatë ekzistuese në kushte të njëjta me ato të aplikuara në transaksione më të hershme.

Ndikimi mbi klientët/huamarrësit

Klientët e shoqërisë mund të ndikohen nga likuiditeti i ulët i cili mund të ndikojë aftësinë e tyre për të paguar detyrimet. Kushtet operuese të përkeqësuar për klientët mund të ndikojnë gjithashtu edhe flukset e parashikuar të drejtimit dhe vlerësimin e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe jo-financiare. Mbi bazën e informacionit të disponuar, Drejtimi i Shoqërisë ka reflektuar vlerësime të rishikuara të flukseve të pritshme në vlerësimin e humbjes.

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

5. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor 2024 janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Paraja në bankë	1,767,600	536,607
Paraja në arkë	163	206
	1,767,743	536,813

6. Stoqet

Stoqet më 31 dhjetor 2024 janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Stoqet	111,419	37,993
	111,419	37,993

7. Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera me 31 dhjetor 2024 paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe tjera	1,818,919	1,504,030
Provizionimi	(21,635)	(21,635)
	1,797,285	1,482,395

8. Parapagimet dhe kërkesat tjera

Parapagimet dhe kërkesat tjera me 31 dhjetor 2024 paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Parapagimi i sigurimit	1,498	4,355
Parapagime tjera	7,655	134,567
	9,153	138,922

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

9. Prona, pajisjet dhe implantet

	Asetet e rivlerësuara	Ndërtesa	Makinat dhe pajisjet	TOTALI
a) Kosto				
Gjendja më 01.01.2023	178,000	10,030,337	6,797,883	17,006,220
Shtesat	-	-	139,319	139,319
Shitjet/largimet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31.12.2023	178,000	10,030,337	6,937,202	17,145,539
Shtesat	-	-	402,422	402,422
Shitjet/largimet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31.12.2024	178,000	10,030,337	7,339,624	17,547,961
b) Zhvlerësimi i akumuluar				
Gjendja më 01.01.2023	165,400	9,781,783	4,656,134	14,603,317
Shpenzimet e zhvlerësimit	4,400	35,056	681,916	721,372
Shitjet/largimet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31.12.2023	169,800	9,816,839	5,338,050	15,324,689
Shpenzimet e zhvlerësimit	4,400	35,056	559,708	599,164
Shitjet/largimet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31.12.2024	174,200	9,851,895	5,897,758	15,923,853
c) Vlera neto				
Më 31.12.2023	8,200	213,498	1,599,152	1,820,850
Më 31.12.2024	3,800	178,442	1,441,866	1,624,108

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

10. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera me 31 dhjetor 2024 paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe tjera	220,489	179,370
	220,489	179,370

11. Te hyrat e shtyra nga grantet

Të hyrat e shtyra nga grantet me 31 dhjetor 2024 paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Detyrimet e shtyra tatimore pjesa afatshkurtër	34,757	34,758
Detyrimet e shtyra tatimore pjesa afatgjata	339,829	174,586
	374,586	209,344

12. Të pagueshmet tjera

Te pagueshmet tjera me 31 dhjetor 2024 paraqiten si me poshtë:

	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Tatimi i mbajtur ne burim per paga te puntoreve	5,888	5,900
Kontributet pensionale	8,806	8,100
Tatimi në qira	-	-
Tatimi ne fitim	58,924	87,798
Tjera	-	2,723
	73,618	104,521

13. Te hyrat nga shitja

Te hyrat nga shitja për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 paraqiten si me poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Të hyrat nga shitja	3,385,907	2,881,076
	3,385,907	2,881,076

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

14. Kostoja e shitjes

Kostoja e shitjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 paraqitet si me poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
KMSH (kosto e shërbimeve dhe mallit)		
Stoku në fillim	37,993	33,981
Shtesat gjatë vitit	1,155,532	419,931
Gjithsejt Stoku+Shtesat	1,193,525	453,912
Stoku në fund 31.Dhjetor	111,419	37,993
a) Gjithsejt KMSH (kosto e shërbimeve dhe mallit)	1,082,106	415,919

15. Shpenzimet e personelit

Kostot e personelit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 paraqitet si me poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Paga bruto	311,624	889,926
Kontributet pensionale - punëdhënësi	15,812	44,496
	327,205	934,423

16. Shpenzimet administrative

Shpenzimet administrative për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 përfshijnë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Shpenzimet e energjisë elektrike	8,476	7,420
Shpenzimet e qirase	31,049	67,202
Shpenzimet për mirëmbajtje të automjeteve	1,546	1,309
Shpenzimet për furnizime të zyres	17,070	16,888
Te tjera	62,044	18,737
	120,184	111,556

Kompania Për Menaxhimin E Deponive Në Kosovë SH.A.
Politikat kryesore të kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese (Euro) për pasqyrat
financiare të përfunduara më 31.12.2024

17. Tatimi ne fitim

Tatimi mbi të ardhurat përbëhet nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024 dhe periudhës paraprake. Deklaratat tatimore paraqiten çdo vit, por fitimet ose humbjet e deklaruarat për qëllime tatimore mbeten provizore deri në kohën kur autoritetet tatimore ekzaminojnë kthimet dhe regjistrat e tatimpaguesit dhe lëshohet një vlerësim përfundimtar. Ligjet dhe rregulloret tatimore të Kosovës janë subjekt i interpretimeve nga autoritetet tatimore.

Shpenzimet e tatimit në fitim për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023
Fitimi/humbja kontabël	1,296,566	730,627
Korrigjimi për shpenzimet	7,166	7,204
Korrigjimi për të hyrat tjera	9,840	132,946
Fitimi/Humbja para tatimit	1,313,572	870,777
Tatimi 10%	131,357	87,798

18. Transaksionet me palët e lidhura

Nuk ka transaksione me palët e lidhura.

19. Ngjarjet pas datës së bilancit

Nuk ka ngjarje tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime në pasqyrat financiare të periudhës kontabël 2024.

Ngjarjet e jashtëzakonshme

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së autorizimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

20. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar më **01.04.2025**.